



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1015_09_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 19.09.2013.

në seancën e mbajtur më datë 24 tetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Z.R. (parashtruesi i ankesës B. F. me shifër të konsumatorit: DPR – 11113) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1015_09_13 i datës 04.09.2013.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës me datë 22.03.2013 ka bërë një kërkesë në Departamentin për Konsumator në KEDS me të cilën ka kërkuar që të shlyhet borxhi i energjisë elektrike të krijuar nga persona në mënyrë të kundërligjshme. Konsumatori në kërkesë ka theksuar se kjo ngarkesë e borxhit të energjisë elektrike përfshinë periudhën kohore prej muajit tetor të vitit 1999 gjer me 17.03.2001. Në kërkesë theksohet se këto shpenzime të energjisë elektrike nuk i ka bërë ai, por dikush tjetër dhe pa të drejt i janë ngarkuar dhe të gjitha faturat gjerë më datën e lartcekur kanë qenë në emër të pronarit të atëhershëm të banesës S. T.

Parashtruesi i ankesës ka prezantuar kontratën e shitblerjes së banesës të lidhur me datë 17.03.2001 në mes të S. D. T. në cilësinë e shitësit të banesës dhe B. F. në cilësinë e blerësit të banesës e cila gjendet në Rrugën “Vëllezërit Gërvalla, B5,H4,Nr.3”, Prishtinë. Kjo kontratë është e vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 19.03.2001.

Nga kartela e konsumatorit shihet se konsumatori me datë 10.12.2002 ka lidhë një kontratë me KEK-un për riprogramim të borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej 2,366.00€ të krijuar nga persona në mënyrë të kundërligjshme, pasi që ka qenë i detyruar nga KEK-u të bëjë një veprim të tillë, apo në të kundërtën është informuar se do të shkyçet nga rrjeti elektrik.

Gjithashtu nga transaksionet e konsumatorit shihet se konsumatorit me shifër DPR -11113, me datë 31.12.2002 KEK i ka hequr një pjesë të borxhit në vlerë prej 1,190.00€ duke u mbështetur në



Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2002/19 dhe 2002/20, të nënshkruar nga Administratori i atëhershëm i Kosovës.

Në bazë të ankesës së konsumatorit të datës 22.03.2013, Departamenti për Konsumator në KEK me datë 21.06.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në kontratën e shitblerjes së banesës me nr. 1478/01 të datës 17.03.2001 si dhe pasqyrën e shpenzimit (leximit).

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 26.07.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 04.09.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1) KKDFE obligohet që të shkarkoi nga borxhi i energjisë elektrike shifrën DPR- 11113 e cila evidentohet në emër të Z. R. që përfshin periudhën deri me datën e nënshkrimit të kontratës më 17.03.2001. 2) KKDFE duhet që për borxhin e krijuar në shifrën DPR – 11113 sipas pikës 1 të këtij vendimi ta kërkoj përmes procedurës gjyqësore nga personat të cilat e kanë krijuar atë borxh të energjisë elektrike. 3) KKDFE pas marrjes së veprimeve në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi obligohet që shifra DPR-11113 të kaloi nga emri i Z. R. në emër të pronarit të ligjshëm të banesës B. F.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 17.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se parashtruesi i ankesës përveç një kontrate të shitblerjes nuk ka prezantuar asnjë dokument tjetër dhe se i njëjti as që është legjitimua në këtë banesë si shfrytëzues i energjisë elektrike pasi që në këtë shifër figuron emri i Z. R. Gjithashtu në pikën tjetër të ankesës KEDS thekson se ndërrimi i emrit nga konsumatori në konsumator është ekzekutua në rastin kur është bërë shlyerja e borxhit në transaksion, ashtu që në rastin konkret KEDS si konsumator legjitim e njeh vetëm Z. R.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24 tetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të shkresave të lëndës e posaçërisht kontratës së shitblerjes së banesës e cila është lidhur me datë 17.03.2001 në mes të S. D. T. në cilësinë e shitësit të banesës dhe B. F. në cilësinë e blerësit të banesës e cila gjendet në Rrugën “Vëllezërit Gërvalla, B5,H4,Nr.3”, Prishtinë, dhe e cila kontratë është e vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 19.03.2001, ka vendosur se kjo dëshmi është e mjaftueshme për vërtetimin e saktë se kur konsumatori ka filluar të shfrytëzoi energjinë elektrike në këtë pikë matëse.

Pretendimet e KEDS, se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se parashtruesi i ankesës përveç një kontrate të shitblerjes nuk ka prezantuar asnjë dokument tjetër janë të paqarta pasi që kontrata e shitblerjes e theksuar më lartë dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale është bazë e mjaftueshme për vërtetimin e pronësisë së parashtruesit të ankesës dhe se kjo kontratë vërteton saktë edhe obligimet se prej kur mund ti ngarkohen këtij konsumatori. Bordi i ZRRE-së, konsideron se mosveprimet e marra nga ana e KEK-ut në atë periudhë kur është krijuar ky borxh dhe mos inkasimi i tij nga ana e shfrytëzuesve para lidhjes së kontratës nga konsumatori, nuk mund t'i ngarkohen pronarit tani të ligjshëm pasi që edhe dispozitat ligjore nuk e lejon këtë veprim.

- ✓ Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e*



shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja.

- ✓ Gjithashtu nëni 5 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve, andaj KEK në këtë rast nuk ka vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk ka arrit të inkasoj borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull.*

Sa i përket pikës së dytë të kundërshtuar në ankesë nga ana e KEDS, ku theksohet se ndërrimi i emrit nga konsumatori në konsumator është ekzekutua në rastin kur është bërë shlyerja e borxhit në transaksion, ashtu që në rastin konkret KEDS si konsumator legjitim e një vetëm Z. R. Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit edhe të kësaj pike ka vërejtur se pjesa e borxhit të shlyer është bërë sipas Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2002/19 dhe 2002/20, të nënshkruar nga Administratori i atëhershëm i Kosovës dhe i cili borxh nuk ka të bëjë me borxhin kontestues ky borxh ka të bëjë pas lidhjes së kontratës, ndërsa sa i përket borxhit të krijuar para lidhjes së kontratës së shitblerjes KEK atëherë nuk ka marr asnjë veprim për inkasim apo shlyerjen e borxhit për konsumatorin e ri.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1033_09_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar